Te ardhurat nga qeraja mbi pronat per investime njihen si fitime ose humbje ne menyre lineare pergjate afatit te qerases. Incentivat e dhena gjate afatit te qerases jane njohur si nje pjese integrale e te ardhurave totale nga qeraja, pergjate afatit te qerases.

(n) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen atehere kur ndodhin.

(o) Qiratë

Shoqëria ka implementuar për herë të parë Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar në lidhje me qiratë SNRF 16 më 1 tetor 2022. Shoqëria ka zgjedhur që efektet që lindin nga aplikimi për herë të parë i SNRF-ve të raportohen në pasqyrat financiare të vitit që mbyllet me 31 dhjetor 2022 pa kryer modifikime në pasqyrat e vitit që mbyllet me 31 dhjetor 2021 dhe 2020.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019), përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë. Të gjitha qiratë rezultojnë që qiramarrësi merr të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të periudhës së qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen përgjatë kohës, gjithashtu merr financim. Rrjedhimisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operative ose qira financiare siç kërkohej nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimeve nga qiramarrësit.

Shoqëria ka njohur: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, pasi nuk ka pasur raste kur aktivi është me vlerë të ulët; dhe (b) amortizimin e aktiveve të marra me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

SNRF 16 mbart të njëjtat kërkesa për kontabilizimin e qirasë nga qiradhënësit si SNK 17, por që tek Shoqëria nuk ka impakt.

Matja fillestare

Matja fillestare e aktivitetit me të drejtë përdorimi

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit mat aktivin me të drejtë përdorimi me kosto. Kosto e aktivitetit me të drejtë përdorimi do të përfshijë;

- a) shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë sic përshkruhet më poshtë;
- b) çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit minus çdo stimul qiraje të marre;
- c) çdo kosto fillestare të drejtëpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi; dhe
- d) dhe një vlerësim të kostove që do të ndodhin nga qiramarrësi për cmontimin dhe lëvizjen e aktivitetit bazë.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(o) Qiratë (vazhdim)

Matja fillestare e detyrimit të qirasë

Në datën e fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar në atë datë. Pagesat e qirasë skontohej duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi do të përdor normën rritëse të huamarrjes së Shoqërisë.

Matja e mëpasshme

Matja e mëpasshme e aktivitetit me të drejtë përdorimi

Pas datës së fillimit, Shoqëria në rolin e qiramarrësit e mat aktivin me të drejtë përdorimi duke përdorur modelin e kostos.

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë bëhet si më poshtë:

- a) duke rritur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë;
- b) duke pakësuar vlerën kontabël (neto) për të reflektuar pagesat e qirasë;
- c) duke rimatur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar cdo rivlerësim ose modifikim të qirasë.

(p) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë te ardhurat nga interesi i balancave me bankat dhe te ardhurat nga kembimi valuator që njihen si fitime ose humbje. Te ardhurat nga interesi njihen mbi baze rrjedhese, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kembimi valutor.

(q) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin ose humbjen për vitin përfshin tatimin aktual dhe atë të shtyre. Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve përveç pjesës që lidhet me zera të njohur drejtpërdrejt në kapital, rast në të cilin ai njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pagueshem i pritshëm mbi te ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e hartimit të bilancit, dhe cdo rregullim të tatimit të pagueshem në lidhje me vitet e kaluara.

Tatimi i shtyre llogaritet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit, duke siguruar diferencat e perkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qelime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qelime tatimi. Shuma e llogaritur e tatimit të shtyre bazohet në mënyrën e pritshme të realizimit ose shlyerjes së vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e përgatitjes së bilancit.

Një aktiv i shtyre tatimor njihet vetëm në qoftë se ekziston mundësia e realizimit të fitimeve të tatueshem përkundërt të cilëve aktiviteti mund të përdoret. Aktiviteti tatimor të shtyre reduktohet në momentin që nuk është më e mundur që përfitimet tatimore të lidhura me to të realizohen.



(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(r) Standarte të reja dhe interpretime që kanë filluar të zbatohen

Ne datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, kishin dale interpretimet dhe amendimet e reja të mëposhtme të standarteve me rendesi për veprimtaritë e Shoqërisë, që kanë hyrë në fuqi dhe janë zbatuar plotësisht gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare:

IFRS 7 Instrumentet financiare ; Shenime Sqaruese.

Standarti do të kërkojë me shumë sqarime në lidhje me instrumentet financiare të Shoqërisë. Ai zëvendëson SNK 30, Shenimet sqaruese në Pasqyrat Financiare të Bankave dhe të Institucioneve Financiare të Ngjashme dhe është i zbatueshëm nga të gjitha njesitë që përgatisin pasqyra financiare në përputhje me SNRF. Shoqëria gjykon se sqarimet e rendesishme shtese që kërkojnë do të lidhen me objektivat, politikat dhe proceset e drejtimit të rizikut të saj financiar.

IFRS 8 Segmentet Operative

Standarti kërkon shenimet sqaruese mbi segmentin bazuar mbi përbersit e njesisë që menaxhimi monitoron gjatë marrjes së vendimeve mbi çështjet operative. Segmentet operative janë përberes të një njesie për të cilët është i disponueshëm informacion financiar i vecantë që vlerësohet rregullisht nga marresi kryesor i vendimeve operative kur vendos se si t'i shpërndajë burimet dhe kur vlerëson performancën. Shoqëria gjykon se kërkesat e standartit do të kenë ndikim pjesërisht të rendesishëm mbi pasqyrat financiare.

IFRIC 7 Zbatimi i Përqasje se Korrigjimit sipas IAS 29 Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacionare, kërkon zbatimin e IAS 29 kur një ekonomi fillimisht shndërrohet në hiperinflacionare dhe në vecanti në kontabilizimin e tatimit të shtyre . IFRIC 7, i cili është bërë i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin 2018, nuk ka ndonjë ndikim mbi pasqyrat financiare.

IFRIC 8 Qëllimi i IFRS 2 Pagesat me ane të aksioneve adreson kontabilizimin e transaksioneve të pagesat me ane të aksioneve ku disa ose të gjitha mallrat apo shërbimet e marra nuk mund të identifikohen në mënyrë specifike. IFRIC 8 i cili është bërë i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin 2019, nuk ka ndonjë ndikim mbi pasqyrat financiare.

IFROC 9 Rivlerësimi i Derivateve të Fshehur kërkon që një rivlerësim nëse derivativet e nënkuptuar duhet të ndahen nga kontratat baze mëkeprirëse të bëhet vetëm kur ka ndryshime në kontratë. IFRIC 9, është bërë i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin 2019, nuk ka ndonjë ndikim mbi pasqyrat financiare.

IFRIC 10 Raportimi Financiar dhe Perkeqesimi i Ndermjetëm ndalon kthimin mbrapsht të një humbjeje nga perkeqesimi të njohur në një periudhë të mëparshme të ndermjetme në lidhje me emrin e mirë, investimin në një instrument kapitali ose aktivin financiar të mbajtur me kosto. IFRIC 10, i cili është bërë i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin 2019, nuk ka ndonjë ndikim mbi pasqyrat financiare.

IFRIC 11 IFRS 2 Grup dhe Transaksionet me Aksione Thesari kërkon që një marrveshje me pagesa me ane të aksioneve në të cilën një entitet merr të mira dhe shërbime në shkëmbim të instrumentave të kapitalit e cila duhet të njihet si një transaksion me pagesa me ane të aksioneve, pavarësisht nëse instrumentat e kapitalit janë marrë. Po ashtu jep udhëzime në marrveshjet e transaksioneve me aksione, në të cilat furnizuesit e të mirave dhe shërbimeve të një entiteti janë dhënë me instrumenta kapitali të shoqërisë mëmë të entitetit, dhe duhet të njihet si një transaksion me pagesa me ane të aksioneve, pavarësisht nëse instrumentat e kapitalit janë marrë në konsideratë në pasqyrat financiare të entitetit. IFRIC 11, i cili është bërë i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin 2019, nuk ka ndonjë ndikim mbi pasqyrat financiare.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

III. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

(r) Standarte të reja dhe interpretime që kanë filluar të zbatohen (vazhdim)

IFRIC 12 Rregullimi i Sherbimeve të Koncesionit udhëzon njesite e sektorit privat mbi ceshtje të caktuara të njohjes dhe matjes që lindin në kontabilitet për rregullimet e shërbimeve të koncesionit nga sektori publik tek ai privat. IFRIC 12 i cili është bere i detyrueshem për pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin 2019, nuk do të ketë ndonjë ndikim mbi pasqyrat financiare.

Amendimi i IAS 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare; Si një amendim plotësues i lindur nga IFRS 7 (shiko me sipër), standarti do të kërkojë me shumë shënime sqaruese në lidhje me kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria nuk prek që ky amendim të kërkojë sqarime të rëndësishme shtese përse i përket strukturës së kapitalit të shoqërisë.

IFRIC 14 IAS 19-Limiet e një Aktivi Benefiti të percaktuar, Kërkesat dhe nderveprimi i Financimeve Minimale sqaron kur rimbursimet dhe reduktimet në kontributet e ardhshme në lidhje me aktivet e benefiteve të percaktuara duhet të trajtohen si të vlefshme dhe jep udhëzime në ndikimin e kërkesave të financimit minimal (MFR) të këtij aktivi. Po ashtu adreson kur një MFR mund të krijojë një detyrim. IFRIC 14, i cili është bere i detyrueshem për pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin 2019, nuk ka ndonjë ndikim mbi pasqyrat financiare.

(o) GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, VLERËSIME DHE SUPOZIME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në mënyrë prospektive. Informacioni mbi supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material të vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit që përfundon më 31 dhjetor 2022 është njohja e aktivitetit tatimor të shtyrë.

Aktiviteti tatimor të shtyrë të njohura përfaqësojnë tatimin mbi fitimin që mund të rikupërohet përmes zbritjeve të ardhshme nga fitimet e tatueshme, kryesisht të lidhura me diferencat midis amortizimit kontabël dhe fiskal të aktiveve afatgjata materiale, duke rezultuar në bazën tatimore të këtyre aktiveve më të larta se vlerat përkatëse të tyre kontabël. Aktiviteti për tatime të shtyrë njihen në atë masë që është e mundur që do të ketë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

IV. Administrimi i riskut financiar

Veshtrim i përgjithshëm

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrisqeve të mëposhtme për shkak të përdorimit të instrumentave financiarë :

- Risku i kredise
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Ky shenim paraqet informacion mbi ekspozimin e shoqërisë ndaj secilit risk të përmendur me sipër objektivat e Shoqërisë, politikat dhe proceset për matjen dhe administrimin e riskut, dhe për administrimin e kapitalit të shoqërisë. Shënime të tjera cilësore dhe sasore janë të përfshira në pasqyrat financiare.

Drejtoria ka përgjegjësinë për krijimin dhe kontrollin e sistemit të administrimit të riskut për Shoqërinë. Drejtoria raporton rregullisht tek Këshilli mbikqyres mbi aktivitetin e tij.

Politikat për administrimin e riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqëria, për të përcaktuar limitet dhe kontrollet e përshtatshme për çdo risk dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve.

(i) Risku i kredise dhe përqendrimi

Risku i kredise është risku i humbjes financiare për Shoqërinë në qoftë se një kliente ose pala tjetër në një instrument financiar nuk i përmbush detyrimet kontraktuale dhe rrjedh kryesisht prej arketimeve të Shoqërisë nga klientet dhe letrat me vlerë të investimit.

Investimet

Shoqëria ka investime financiare.

(ii) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të arrijë të plotësojë detyrimet e saj financiare në maturimin e tyre. Rruga që ndjek Shoqëria për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, për aq sa ka mundësi, që do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në maturim, në kushte normale dhe të forcuara, pa krijuar humbje të papranueshme ose demtime riskore për reputacionin e Shoqërisë.

(iii) Risku i tregut

Risku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kursi i këmbimit dhe normal e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose në vlerën e instrumentave të saj financiar. Objektivi i administrimit të riskut të tregut është të administrojë dhe të kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që pritet një kthim optimist.

(iv) Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë domethënëse ndaj riskut të kursit të këmbimit. Transaksione të tjera të rendesishme kryen në monedha të tjera si Euro ose USD.

Kredite dhe huatë regjistrohen në monedhën me të cilën do të ketë hyrje në para nga operacioni në fjalë i Shoqërisë.



(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

5. Aktivet Afatgjate

Aktivet afatgjate materiale dhe jo materiale te shoqerise me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	Instalime teknike, makineri dhe pajisje	Mobilje dhe pasuri	Mjete transporti	Pajisje informatike	Te tjera	Totali
AAM Vlera Bruto						
Gjendje 01.01.2022	517,756	9,762,447	8,296,290	11,886,999	10,796,644	41,260,136
Shtesa	-	-	-	1,178,352	-	1,178,352
Pakesime	-	-	(1,674,864)	-	-	(1,674,864)
Riklasifikime nga CIP	-	-	-	-	-	-
Gjendje 31.12.2022	517,756	9,762,447	6,621,426	13,065,351	10,796,644	40,763,624
ZHVLERESIM I AKUMULUAR						
Gjendje 01.01.2022	367,146	6,223,381	5,603,109	5,884,032	2,513,447	20,591,115
Shtesa	37,653	707,813	547,598	1,684,427	1,207,434	4,184,925
Pakesime	-	-	(1,674,861)	-	-	(1,674,861)
Riklasifikime nga CIP	-	-	-	-	-	-
Gjendje 31.12.2022	404,799	6,931,194	4,475,846	7,568,459	3,720,881	23,101,179
Vlera e mbetur neto						
Gjendje 01.01.2022	150,610	3,539,066	2,693,181	6,002,967	8,283,197	20,669,021
Gjendje 31.12.2022	112,957	2,831,253	2,145,580	5,496,892	7,075,763	17,662,445

Heliuss Systems Sh.p.k.
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. E drejta e përdorimit të aseteve

E drejta e përdorimit të aseteve më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si me poshte:

	<u>Ambjente me qera</u>
<i>Vlera Bruto</i>	
Gjendje 01.01.2022	-
Shtesa	8,006,222
Pakesime	-
Gjendje 31.12.2022	<u>8,006,222</u>
 <i>ZHVLERESIM I AKUMULUAR</i>	
Gjendje 01.01.2022	-
Shtesa	(710,071)
Pakesime	-
Gjendje 31.12.2022	<u>(710,071)</u>
 <i>Vlera e mbetur neto</i>	
Gjendje 01.01.2022	-
Gjendje 31.12.2022	<u>7,296,151</u>

Detyrimi për qirane financiare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si me poshte:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Detyrim për qera financiare afatshkurter	3,314,921	-
Detyrim për qera financiare afatgjate	3,937,349	-
	<u>7,252,270</u>	<u>-</u>

7. Investime ne pjesemarrje

Investimi ne pjesemarrje I shoqerise me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si me poshte:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Investime ne pjesemarrje	525,000	5,625,000
Zhvleresim investimi ne pjesemarrje	(525,000)	-
	<u>-</u>	<u>5,625,000</u>

Shoqeria gjate vitit 2022 ka shitur aksionet e "Platforma virtuale farm and market" sha dhe per "Blockchain" sh.a, shoqeria ka vendosur te write-off investimin ne pjesmarrje duke qene se Blockchain sh.a nuk po gjeneron te ardhura.

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. Llogari te arketueshme tregtare

Llogarite e arketueshme tregtare te shoqerise me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Te arketueshme ne monedhen LEK	83,449,475	96,499,357
Te arketueshme ne monedhen EUR	16,589,198	60,752,104
Zhvleresimi i llogarive te arketueshme	(7,377,183)	-
	<u>92,661,490</u>	<u>157,251,461</u>

9. Llogari te tjera te arketueshme

Llogarite e tjera te arketueshme te shoqerise me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Garanci bankare	5,352,500	10,654,000
TVSH	4,597,580	3,417,818
Te tjera te arketueshme	3,495,438	-
Garanci KOASH	1,095,653	1,095,653
Parapagime nga furnitoret	-	30,047
Hua clever solutions	-	1,500,000
	<u>14,541,171</u>	<u>16,697,518</u>

Kompania qe po konsolidohet Clever Solutions shpk eshte blere gjate vitit 2022 nga Shoqeria. Prandaj huaja e paraqitur nuk eshte eliminuar.

10. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e shoqerise me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Banka	57,342,938	76,140,074
Ne Eur	32,215,159	65,421,840
Ne LEK	14,419,980	6,323,547
Ne USD	10,707,799	4,394,687
Arka	753,845	3,263
Ne LEK	753,845	3,263
Ne USD	-	-
	<u>58,096,783</u>	<u>76,143,337</u>

Helius Systems Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

11. Kapitali

Shoqeria zoteron një kapital prej 1,000, 000 Leke me 31 dhjetor 2022 dhe 1,000,000 Leke me 31 dhjetor 2021.

12. Huamarrje nga palet e lidhura

Huamarrjet nga palet e lidhur te shoqerise me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Hua nga ortakut	-	34,739,273
	<u>-</u>	<u>34,739,273</u>

13. Grante dhe te ardhura te shtyra

Grantet dhe te ardhurat e shtyra te shoqerise me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Grante te marra	3,495,438	-
	<u>3,495,438</u>	<u>-</u>

Granti i marre eshte nga Helvetas me 18.08.2022 me vlere totale prej 48,600 Eur lidhur me sherbimin e nje sistemi per te ndihmuar eksportuesit e agrokultures per te aksesuar me lehte tregjet. Gjate vitit 2022 eshte regjistruar ne te ardhura vlere prej 18,000 Eur.

14. Llogari te pagueshme tregtare

Llogarite e pagueshme tregtare te shoqerise me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	<u>Më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Më 31 dhjetor 2021</u>
Te pagueshme ne monedhen LEK	16,332,475	22,329,497
Te pagueshme ne monedhen te huaj	220,000	-
	<u>16,552,475</u>	<u>22,329,497</u>

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

15. Llogari te tjera te pagueshme

Llogarite e tjera te pagueshme tregtare te shoqerise me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
TVSH e pagueshme	7,320,389	7,092,518
Parapagime	5,202,630	5,177,844
Paga dhe shperblime	3,112,048	570,854
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	1,721,416	1,577,077
Tatim mbi fitimin	1,612,507	2,331,372
Tatim mbi të ardhurat personale	1,392,826	1,725,839
Te tjera	802,047	1,500,000
	21,163,863	19,975,504

16. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Te ardhura nga sherbimi i mirembajtjes	275,963,322	242,252,585
Te ardhura nga sherbime informatike	66,983,197	31,157,807
Te ardhura nga shitja e programeve	14,486,911	7,999,662
	357,433,430	281,410,054

17. Kosto qe lidhen me sherbimet

Kostot qe lidhen me sherbimet e shoqerise per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Sherbime komisionesh	22,504,821	-
Shpenzime te tjera per aktivitetin	629,199	18,485,326
	23,134,020	18,485,326

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

18. Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit

Te ardhurat e tjera te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Te ardhura te tjera	11,045,535	-
Te ardhura nga grante	2,060,640	-
	13,106,175	-

19. Shpenzime te tjera

Shpenzimet e tjera te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Shpenzime te tjera	43,988,992	19,048,359
Shpenzime per personelin	16,097,397	2,800,252
Shpenzime karburanti	8,047,382	5,934,806
Shpenzime zhvleresimi	7,902,182	-
Qira per aktivitetin	3,462,968	4,632,551
Shpenzime konsulence	3,012,539	1,549,450
Komisione bankare	2,292,775	444,946
Shpenzime noteriale dhe perkthimi	317,136	271,030
Taksa dhe tatime	254,939	117,683
Shpenzime sigurimi	191,421	177,113
Mirembajtje dhe riparime automjete	7,000	125,275
	85,574,731	35,101,465

20. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Pagat e punonjesve	94,385,100	91,587,014
Kontributet shoqerore dhe shendetesore	11,979,654	10,825,038
	106,364,754	102,412,052

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

21. Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto

Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Humbje nga kembimet valutore	6,262,531	3,091,554
Shpenzime Interesi	16,545	470
Te ardhura te tjera financiare	(168,358)	(1,756,688)
Te ardhura nga kembimet valutore	(1,782,254)	(301,219)
	4,328,464	1,034,117

22. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin e shoqërise më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fitim/(Humbja) e vitit	151,519,219	120,998,236
Shpenzime te panjohura	-	-
Fitimi i tatueshem per periudhen	151,519,219	120,998,236
Perqindja e tatim fitimit mema	5%	5%
Perqindja e tatim fitimit bija	15%	15%
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-	6,049,912
	151,519,219	114,948,324

23. Llogari te pagueshme nga palet e lidhura

Logarite e pagueshme nga palet e lidhura te shoqërise më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si me poshte:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Te paguesheme nga palet e lidhura	(5,137,772)	(33,962,177)
Te arketueshme nga palet e lidhura	-	-
Huamarrje nga palet e lidhura	-	(35,264,273)
	(5,137,772)	(69,226,450)

(Vlerat në mijë lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

24. ANGAZHIME, GARANCI DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA

Çështje ligjore

Shoqëria gjatë rrjedhës së rregullt të aktivitetit të saj është përfshirë në çështje të ndryshme ligjore nën gjykim si paditës dhe palë e paditur nga palë të treta. Shoqëria ka një pritshmëri pozitive për të gjitha çështjet gjyqësore.

Detyrime të mundshme tatimore

Legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose që konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të 2017, është objekt i interpretimeve të ndryshme përsa i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor i ndërmarrë nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Nën rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

25. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime ose informacione shpjeguese shtesë në këto pasqyra financiare.

